

## PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

### VEPRIMTARITE E LENDES SE DRURIT

**ID 7.10/b** “Pervec rasteve te permendura ne kategori te tjera te kesaj shtojce, prodhimi i produkteve te perbera tersisht apo kryesisht nga druri n.q.s, veprimtaria perfshin: sharrimin, shpimin, ferkimin me rere, gdhendje, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik te drurit.”

*(sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)*

**PERSON FIZIK “Fatjon ALCANI”**

**NIPT L91311008M**

**VENDNDODHJA** Tirane Zall Herr CERKEZE-MORINE Njesia  
Administrative Zall Herr, Rruga Qender, Nr.1.

## 1. PROFILI I OPERATORIT

Subjekti “**Fatjon Alcani**” eshte i regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, se status ligjor si **Person Fizik**, me Nr. **NIPT L91311008M**, me perfaqesues ligjor **Fatjon Alcani** ne adresen **Tirane Zall Herr CERKEZE-MORINE Njesia Administrative Zall Herr, Rruga Qender, Nr.1.**

Operatori do te pajiset me leje tipi B per aktivitetin:

**ID 7.10/b** “*Pervec rasteve te permendura ne kategori te tjera te kesaj shtojce, prodhimi i produkteve te perbera tersisht apo kryesisht nga druri n.q.s, veprimtaria perfshin:sharrimin, shpimin, ferkimin me rere, gdhendje, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik te drurit*”.

**Klasifikimi bazuar ne ligjin 10448 datë 14.07.2011, të ndryshuar:**

Referuar shtojces 1 te ligjit 52/2020 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR”.

## 2. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
- Ndikimi ne flore/faune;
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
- Ndikime social-ekonomike;
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor;
- Ndikim ne peizazhin e zones;

-Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

### 3. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT

Vendndodhja e aktivitetit është: **Tirane Zall Herr CERKEZE-MORINE Njesia Administrative Zall Herr, Rruga Qender, Nr.1**



Koordinatat e vendndodhjes se subjektit "Fatjon Alcani"

Nr	X	Y
1.	4398006.57	4585140.92

#### 4. MENAXHIMI I INSTALIMIT

KUSHTET E PUNËS					
Numri total i punonjësve	16				
Shpërndarja e punonjësve	ZYRA	PRODHIMI	MIRËMBAJTJA	MAGAZINIMI	TË TJERA
	3	5	2	3	Shofer - 3
Turnet dhe aktivitetet	Zyrat / administrata		Instalimet		
	08 <sup>00</sup> -16 <sup>00</sup>		08 <sup>00</sup> -16 <sup>00</sup>		
Orët e punës	Zyrat / administrata		Instalimet		
	8 orë/ditë		8 orë/ditë		
Numri i ditëve të punës në vit	312 ditë/vit				
Numri i orëve në vit	312 ditë x 8 orë = 2496 orë/vit				
Periodhat gjatë të cilave kompania mbyllet	Pushimet		Dita e dielë është pushim. Gjithashtu sipas kodit të punës, punëmarrësve u takojnë 20 ditë/pune pushimit në vit.		
	Ndërprerje të rregullta të funksionimit		Dita e diele pushim.		

#### 5. PERSHKRIMI AKTIVITETIT

**ID 7.10/b** “Përveç rasteve të permendura në kategori të tjera të kësaj shtypjeje, prodhimi i produkteve të perbera tersisht apo kryesisht nga druri n.q.s, veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, ferkimin me rere, gdhendje, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit”.

Lende të para	Lende/materiale ndihmese
Lende drusore	Uji , Energjia elektrike, Pajisje pune


### Procesi teknologjik

Trupat me ane ten je makine transportuese (Pirun), vendosen ne platformen e trupave perpara sharres shiriti tipi DOGAN Makina SANAYI, automatike, prodhim turk. Vendoset trupi I sharres ne karrel dhe realizohet sharrimi me modelet maksimale. Pas sharrimit derrasat kalojne ne circular dhe ne diskun pendul.

Derrasat prodhohen ne dimensione te ndryshme, sipas porosive.



*Sharra Shirit DOGAN Makina SANAYI, automatike*



*Karrel me komandim automatic te Avances*

Cilesia dhe kostoja e lendes drusore varet nga shume karakteristika si:

- Lloji I drurit
- Permbajtja e lageshtise se tij
- Teknologjia e perpunimit dhe sharrimi



*Ruajtja e lendes se drurit*


Sharrimi I drurit eshte nje cikël veprimesh duke perdorur nje larmi teknologjish qe synojne marrjen e lendes drusore nga druri I rumbullaket I pershtatshem per perdorim te metejshem ne industri.

Lendet drusore, sharrohen se gjati ne makinen sharre-shirit vertikale. Hapat qe ndiqen jane:


- pergatitet Sharra shirit per pune,
- kontrollohet instrumenti preres, shiriti,
- vendoset instrumenti ne makine
- Behet shtrengimi I shiritit
- Regjistrohesh trashesia e prerjes se derrises ose elementit (detalit gjysem te gatshem) sipas modelit te sharrimit te zgjedhur dhe kerkeses per prodhim.

Lenda drusore transportohet me makinen ngarkuese pirun elevator, nga sheshi I depozitimit per ne platformen e karrelit (vagonit).

Vendosen lenda drusore ne karriel. Realizohet sharrimi I trupave, duke kontrolluar cilesine e sharrimit, permasat e produktit lende e sharruar e realizuar.




*Makine per mbrehjen e sharrave*




*Sharre shirit per elemente*

**PLANI I VENDOSJES REPARTI I PERPUNIMIT TE DRURIT**





- 1. Tropa sharre
- 2. Sharro shirit
- 3. Karcki
- 4. Pendul
- 3 Aparat automatik i mprehjes se sharrave


- 1. Sharro shirit
- 2. Sharro shirit
- 3. Aparat automatik i mprehjes se sharrave
- 4. Pendul



## PLANI I VENDOSJES REPARTI I PERPUNIMIT TE DRURIT Subjekti "Fatjon Alcani"



### PLANIMETRIA E REPARTIT TË PËRPUNIMIT TË LËNDËS SË SHARRUAR Subjekti "Fatjon Alcani"





## 6. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMIT I NDIKIMEVE NE MJEDIS

### Ndikime në ajër


Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti, emetimet në ajër janë kryesisht: emetimet e grimcave të ngurta si PM10, PM2.5, TSP dhe gazeve si CO që çlirohen nga mjetet që sjellin lenden e pare në subjekt.

Mund të themi se niveli i shkarkimeve do të jetë Brenda normave të lejuara për shkak se subjekti do të monitorojë këto parametra në mënyrë periodike për të mbajtur nën kontroll shkarkimet. Për punonjësit që do të punojnë në këto reparte, është menduar të pajisen me mjete mbrojtëse si maska apo pasqisje të tjera.

### Ndikime në ujë

Gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk kemi ndotje të ujërave nëntokesorë apo sipërfaqësorë. Natyra e aktivitetit nuk kërkon përdorim të ujit në proceset teknologjike. Ujrat që dalin nga aktiviteti janë ujra të cilat lindin nga shërbimet higjieno-sanitare, të cilat nuk përmbajnë komponente që mund të ndikojnë negativisht në mjedisin ujor prites. Këto ujera do të shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve të zonës, për tu menaxhuar me pas nga Ujesjelles Kanalizime të zonës.


Në objekt nuk do të shkarkohen materiale të rrezikshme dhe si rrjedhojë nuk do të ketë ndotje të ujërave nëntokësore ose sipërfaqësore.






### Ndikimet ne popullesi

Zhvillimi I aktivitetit nga subjekti “Fatjon Alcani” nuk do te kete ndikime ne popullesi. Natyra e ketij aktiviteti nuk shoqerohet me shkarkime ne uje, ajer dhe toke qe mund te cenojne shendetin e banoreve apo bizneseve te ndodhura aty prane.



### Ndikimet në florë/ faunë


Zona në të cilën ushtrohet aktiviteti është një zonë urbane dhe nuk mund të analizojmë ndikime në flore dhe faunë. Operatori do të shtojë siperfaqet e gjelberta për një pamje vizuale me të krenaqshme për syrin dhe për të mirat në pikepamjen mjedisore. Gjithashtu zona karakterizohet nga bimesi e zhveshur dhe nuk takon elemente të spikatur faunatik dhe fluoristik.



### Ndikimet në tokë

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë negativisht në tokë, kjo vjen si rezultat se nuk do të magazinohen lëndë të rrezikshme.

Proceset e punës nuk ndikojnë në tokë, kjo edhe për shkak të ambjenteve të pershtatshme e bashkekohore, të shtruara me beton, të cilat nuk lejojnë kontaminimin e tokës.




### Ndikime nga zhurmat

Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga makineria prerese e drurit, sharrimit, etj. Proceset e prodhimit shoqerohen me clirim zhurme, por nuk vleresohen ne nivele shqetesuese per zonen, vetem per ambjentet e punes. Per kete operatori eshte kujdesur qe punonjesve t'u siguroje pajisje mbrojtese per degjimin.

### Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike historike dhe zonat e mbrojtura

Aktiviteti qe ushtron shoqeria zbatohet ne nje zone ne sipërfaqen e së ciles dhe në nëntokën e saj nuk ka ndertime lidhur me trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore. Kjo tregon qe zona është zonë e lirë për të realizuar kete aktivitet.




### Ndikimet ne klime

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

### Ndikimet e aktivitetit të zhvillimit në rruget lokale dhe transportin

Infrastruktura në të gjithë perimetrin e aktivitetit dhe rruga kryesore është e shtruar me beton. Nuk pritet që të ketë ndikime negative apo ndryshime të infrastruktures.



### Mbetjet

**Mbetje të ngurta urbane** - Tipet e mbetjeve me kodet **20 01 01**, **20 01 02** dhe **20 03 01**, do të gjenerohen nga aktiviteti I punonjesve. Brenda territorit të intalimit janë të vendosuar kontiniere të vegjël (kosha) për hedhjen e mbeturinave dhe me pas depozitohen në pikën e grumbullimit të caktuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore. Operatori për stafin ka vendosur edhe kontiniere me ngjyra në mënyrë që mbetjet të diferencohen që në burim. Kontinieret do të pastrohen në mënyrë të vazhdueshme nga punonjësit e mirembajtjes.

**Mbetje nga proceset e punës** - Mbetjet e drurit që mund të gjenerohen gjatë sharrimit të tij, do të terhiqen nga operatore të licensuar për trajtimin e metejshëm të tyre, me të cilët subjekti do të lidhë kontrate bashkepunimi.

### Ndikimi social-ekonomik

Me operimin e ketij aktiviteti pritet te kete nje impakt pozitiv ne ekonomine e vendit, ne aspektin e punesimit te individeve te zones, padyshim dhe per pushtetin vendor si pasoje e taksave qe operatori paguan.

<b>Analizat S.W.O.T</b>	
<b>Forcat</b>	<b>Dobësite</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Potencial per zhvillimin ekonomik</li> <li>➤ Rritje e punesimit</li> <li>➤ Afersia e tij me zonat kryesore te vendit, industriale, tregtare ben te mundur shtimin e maksimizimit.</li> <li>➤ Kapaciteti per plotesimin e nevojave te tregut</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mungesa e politikave per perkrahjen e subjektit.</li> <li>➤ Evazioni fiskal ne konkurrencen e pa ndershme nga kompani te ndryshme.</li> </ul>
<b>Mundësite</b>	<b>Kërcënimet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mundesi perfitimi ekonomike nga shitja.</li> <li>➤ Mundesi punesimi dhe zgjerimi te aktivitetit.</li> <li>➤ Ofrimi i produkteve cilesore, me cmime te konkurueshem ne tregun vendas.</li> <li>➤ Maksimizimi i fitimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Konkurenca e pa ndershme dhe mos respektimi i detyrimeve dhe percaktimeve ligjore nga subjektet.</li> <li>➤ Dukurite natyrore, kryesisht nga termetet dhe zjarret.</li> </ul>

**7. MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT NGA NDIKIMET  
NEGATIVE**

Mjedisi i ndikuar	Propozime
<b>Toka</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave te percaktuara</li> <li>➤ Zbatimi i kushteve teknike dhe standarteve</li> <li>➤ Pastrim i ambientit te punes</li> <li>➤ Mirmbajtja dhe gjelberimi i siperfaqes</li> </ul>
<b>Biodiversiteti</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mbjellja e fidaneve te rinj, pergjate rruges qe ben te mundur hyrjen per ne objekt apo edhe brenda tij</li> </ul>
<b>Cilesia e Ajrit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Gjate kohes se ardhjes se mjeteve qe sjellin lenden e pare do te fiken qe ne momentin e mberritjes ne subjekt per te mos shkaktuar emetime ne ajer.</li> </ul>
<b>Mbetjet urbane nga aktiviteti i punonjësve që do të operojnë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitimin më të afërt të caktuar nga njësia vendore.</li> </ul>
<b>Zhurmat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Detyrimi i fikjes se automjeteve, si per sigurine ashtu edhe per uljen e gjenerimit te zhurmes.</li> <li>➤ Vendosja e tabelave ne hyrje te instalimit, se nuk lejohet levizja e shpejte e makinave ne subjekt dhe ne afersi te tij.</li> <li>➤ Punonjesve t'u sigurohen pajisje mbrojtese per degjimin.</li> </ul>
<b>Trafiku rrugor Fluksit te qarkullimit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Orinetimi I mjeteve qe ne hyrje te subjektit.</li> <li>➤ Sigurimi I lendes se pare ne subjekt ne orare ku te shmanget piku I trafikut.</li> </ul>

*Person Fizik*

**Fatjon ALCANI**

